

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.26.03.2021*

26.03.2021

Ora 12:46

RENDI I DITËS

**Përcaktimi i relatorit të kërkesës ankimore nr.7, “Kundërshtimii vendimit nr.172,
dt.23.03.2021, subjekti ankues koalicioni ABEOK”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Nuk janë prezent
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje, pranë KQZ-së është paraqitur kërkesa ankimore nr.7 me ankues Koalicionin ABEOK. Brenda afatit ligjor të përcaktuar nga KAS po zhvillohet sot në datën 26.03.2021 ora 12:30, procedura e shortit për ankesën nr.7 për anëtarët e KAS-it. Sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it do të zhvillohet shorti për caktimin e relatorit për anëtarin, për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.7 pa prezencën e anëtarëve të Kas-it. Vazhdojmë procedurën e shortit. Administrata e KQZ-së ka përgatitur 5 shirita letre dhe 5 gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë. Në një nga 5 shiritat e letrës është vendosur shkrimi “Kërkesë Ankimore nr.7” e cila paloset, futet në njëren prej goglave dhe vendoset në enën transparente. 4 shiritat e tjerë që janë të bardhë pa shënime palosen dhe futen në goglat respektive, përkatësisht 4 goglat e tjera. Atëherë 5 shiritat janë futur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente duke qenë se mbledhja zhvillohet pa praninë e anëtarëve të KAS-it. Bazuar në pikën 3 të nenit 14 të rregullatores së KAS-it pika “ç” një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqi goglat në emër dhe për llogari të

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.26.03.2021**

anëtarëve të KAS-it sipas rendit alfabetik ngjitës të emrit, tërheqin nga goglat që janë në enë. Sipas rendit alfabetik një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqi goglën në emër :

Për Z. E. Lako: Tërheq goglën - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. E. Çefa: Tërheq goglën - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. I. Rusmali: Tërheq goglën - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. K. Bele: Tërheq goglën - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. L. Braho: Tërheq goglën - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.7.

Pra, sipas nenit 14 të rregullores së Kasit, administrata shpall që Relatori i Kërkesës Ankimore nr.7 është zoti Ledio Braho, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**

